

LIGJ
Nr. 62/2023

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9917, DATË 19.5.2008,
“PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT
TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në pikën 1 të nenit 2 emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF)”.

Neni 2

Në pikën 2/1 të nenit 5 pas fjalës “fuqi” vihet presje dhe togfjalëshi “dhe parashikimeve të këtij ligji” zëvendësohet me fjalët “parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore përkatëse”.

Neni 3

Pika 1 e nenit 6/1 riformulohet si më poshtë:

“1. Subjektet mund të mbështeten në palët e treta për të kryer masat e parashikuara në këtë ligj me kusht që të sigurohen për përmbushjen e kritereve si më poshtë:”.

Neni 4

Pika 2 e nenit 7 riformulohet si më poshtë:

“2. Për zbatimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientëve, subjektet mund të kërkojnë praninë fizike të klientëve dhe të përfaqësuesve të tyre para se të vendosin një marrëdhënie biznesi.”.

Neni 5

Në pikën 4 të nenit 8 fjalët “veçanërisht kur këto transaksione kryhen pa praninë fizike të klientit” zëvendësohen me fjalët “të vlerësuara me risk të lartë”.

Neni 6

Në nenin 21 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) organizohet si drejtori e përgjithshme në varësi të ministrit përgjegjës për financat dhe ushtron funksionet e autoritetit përgjegjës sipas këtij ligji. Kjo Agjenci brenda fushës së veprimtarisë së vet ka të drejtë të vendosë për mënyrën e ndjekjes dhe të

zgjidhjes së çështjeve të trajtuara për pastrimin e mundshëm të parave dhe financimin e veprimtarive të mundshme terroriste.”.

2. Në pikën 1/1 në fjalinë e parë dhe të dytë emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia e Inteligjencës Financiare”.

3. Në pikën 2 në fjalinë e parë emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia e Inteligjencës Financiare”.

4. Pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, nëpunësve dhe punonjësve administrativë rregullohen në bazë të Kodit të Punës.”.

5. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës Financiare emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat.”.

6. Në pikën 5 në fjalinë e parë emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia e Inteligjencës Financiare”.

Neni 7

Në nenin 22 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fjalinë e parë emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia e Inteligjencës Financiare”.

2. Në shkronjën “b” togfjalëshi “ka akses të drejtpërdrejtë” zëvendësohet me togfjalëshin “ka akses të drejtpërdrejtë pa pagesë”.

3. Në shkronjën “dh” togfjalëshi “që kryen funksione dhe u nënshtrohet detyrimeve të ngjashme të konfidencialitetit” zëvendësohet me togfjalëshin “apo organizma të tjera jashtë vendit, që iu nënshtrohet detyrimeve të ngjashme të konfidencialitetit”.

Neni 8

Në nenin 22/1 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fjalinë e parë akronimi “DPPP-ja” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia e Inteligjencës Financiare”.

2. Në fjalinë e dytë emërtimi “Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohet me emërtimin “Agjencinë e Inteligjencës Financiare”

Neni 9

Në nenin 27 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 8 riformulohet si më poshtë:

“8. Masat administrative përcaktohen dhe vendosen nga Agjencia e Inteligjencës Financiare.”.

2. Në pikën 10, pas fjalisë së dytë, shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Masa e kamatëvonesës për gjobat e vendosura nuk mund të kalojë vlerën e gjobës.”

Neni 10

Në nenin 29 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Ndryshimi i emërimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave në Agjencinë e Inteligjencës Financiare nuk cenon të drejtat dhe funksionet e strukturës, si dhe realizohet në përputhje edhe me detyrimet për bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar.

Të gjitha aktet nënligjore, përfshirë marrëveshjet e bashkëpunimit me struktura brenda dhe jashtë vendit, të nënshkruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, në zbatim të

ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, zbatohen deri në zëvendësimin e tyre me akte të tjera në zbatim të këtij ligji.”.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.7.2023.

Shpallur me dekretin nr.173, datë 28.7.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.